



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "AGE Group shpk" të datës 21.05.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me mobileri urbane në parqe të Kryeqytetit" me nr. të prokurimit 616-26-3071-1-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "AGE Group shpk" të datës 21.05.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me mobileri urbane në parqe të Kryeqytetit" me nr. të prokurimit 616-26-3071-1-1-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëjë korigjimin e kërkesave mbi kapacitetin teknik dhe profesional në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "AGE Group shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 21.05.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me mobileri urbane në parqe të Kryeqytetit" me nr. të prokurimit 616-26-3071-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

**2.1 – Inxhinier ndërtimi (konstruktiv), 10 vite përvojë, Menaxher Projekti
Shkelje e drejtpërdrejtë e Nenit 59 dhe Nenit 7**

- Nuk ekziston asnjë aktivitet konstruktiv në këtë kontratë
- Nuk ka projektim, analizë statike apo mbikëqyrje ndërtimore

Kërkesa është juridikisht e pabazuar dhe funksionalisht e panevojshme, duke tejkalluar çdo standard të proporcionalitetit.

**2.2 – Inxhinier Arkitekture, 10 vite përvojë
Shkelje e Nenit 59 dhe Nenit 7**

- Nuk ka projektim arkitektonik në këtë kontratë
- Furnizimi me produkte të gatshme nuk kërkon ekspertizë arkitekturore

Kjo kërkesë përbën devijim të qëllimshëm nga natyra e kontratës.

**2.3 – Inxhinier i Shkencave të Drurit / Pylltarisë
Shkelje e Nenit 60 dhe Nenit 7**

- OE nuk është prodhues, por furnizues
- Produktet janë të certifikuara dhe të gatshme

Kjo kërkesë është arbitrare dhe pa lidhje funksionale me kontratën, duke krijuar pengesë artificiale në treg.

**2.4 – Inxhinier i Ambientit + certifikime të shumta
Shkelje e Nenit 59 dhe Nenit 28**

- Nuk ka procese që kërkojnë menaxhim ambiental nga OE
- Nuk ka aktivitet ndotës apo operativ

Kërkesa është e fryrë artificialisht dhe ligjërisht e pajustificueshme.

**2.5 – Inxhinier Infrastrukturë Rrugore, 10 vite përvojë
Shkelje flagrante e Nenit 59**

- Nuk ka asnjë element infrastrukturë rrugore
- Nuk ka ndërhyrje në rrugë

Kjo kërkesë është plotësisht jashtë objektivit të kontratës dhe juridikisht e pavlefshme.

**2.6 – Inxhinier Ndërtimi (menaxhim ndërtimi), licencë A
Shkelje e Nenit 60**

- Licencat e ndërtimit kërkohen vetëm për kontrata punësh
- Nuk ka aktivitet që kërkon licencim të tillë

Kërkesa përbën tejkalim të kompetencave të autoritetit kontraktues.

2.7 & 2.8 – Teknik ndërtimi dhe teknik arkitekture

Shkelje e Nenit 7 (proporcionaliteti)

- *Nuk ka punë teknike në terren*
- *Nuk ka kantier ndërtimi*

Këto kërkesa janë të panevojshme dhe diskriminuuese.

2.9 – Specialist saldimi + certifikime sigurie

Shkelje e Nenit 59 dhe 60

- *Nuk ka saldim apo prodhim në këtë kontratë*
- *Produktet janë të gatshme*

Kjo kërkesë është fiktive dhe pa bazë reale.

IV. RAPORTI I RISKUT

Shkelje e Nenit 28

- *Nuk ka vend pune industrial apo kantier*
- *Nuk ka ekspozim ndaj rrezikut operacional*

Kërkesa është e pajustificueshme dhe e vendosur në mënyrë mekanike pa analizë reale.

V. CERTIFIKIMET ISO

Shkelje e Nenit 28 dhe Nenit 59

Kërkesa për:

- *ISO 27001*
- *ISO 28001*
- *ISO 39001*
- *ISO 50001*

nuk kanë asnjë lidhje me furnizimin e mobiluarit urban.

Përbëjnë:

- *kufizim të konkurrencës*
 - *favorizim të operatorëve të caktuar*
 - *shkelje të parimit të proporcionalitetit*
-

Eskavatorë, rul, damper

Përdoren vetëm për punë ndërtimore

Nuk ekziston asnjë aktivitet i tillë

Kërkesë juridikisht e pavlefshme

Kamionë kiper dhe pajisje të rënda transporti

Furnizimi realizohet me transport standard

Kërkesë artificiale dhe kufizuese

Pajisje për beton dhe kompresorë

Nuk ka betonim apo prodhim

Kërkesë jashtë çdo logjike kontraktuale

Pajisje hidraulike për makineri

Lidhen ekskluzivisht me ndërtim

Totalisht të palidhura me kontratën

Lidhur me pretendimet ankimore, pas analizimit me kujdes të kërkesave përkatëse të DT, është konstatuar se kërkesat për inxhinier të arkitekturës (2.2), inxhinier të shkencave të drurit/pylltarisë (2.3), inxhinier të ndërtimtarisë drejtimi i ambientit (2.4), inxhinier i ndërtimtarisë për infrastrukturë rrugore (2.5), inxhinier i ndërtimtarisë për menaxhimin e ndërtimtarisë dhe teknologji (2.6) teknik të ndërtimtarisë (2.7) si dhe një person të trajnuar për saldim sipas EN ISO 9712:2012 (2.9) duhet të largohen. Ndërsa kërkesa për inxhinier të ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv – menaxher të kontratës (2.1) duhet të ndryshohet ashtu që nuk ka nevojë të ketë min. 10 vite përvojë të punës pasi që mjafton që përvoja e punës të jetë së paku 5 vite (pra nga min. 10 vite përvojë ndryshohet në min. 5 vite përvojë).

Kërkesa për raportin e vlerësimit të (3) mbetet e pandryshuar. Po ashtu edhe kërkesat për certifikata ISO mbeten të pandryshuara sepse parashtruesi nuk ka argumentuar pse duhet të hiqen të njëjtat nga DT.

Kërkesa për eskavator me lugë para/mbrapa mbetet e pandryshuar ndërsa kërkesa për eskavator me kapacitet 1-1.5 ton largohet. Tutje kërkesa për kamion me kiper me kran me peshë bartëse 7-9 ton me atest largohet sepse është kërkuar 1 kamion me kiper tjetër dhe nuk ka nevojë të parashtrihen kërkesa të dyfishta. Kërkesa për hillt me derivate mbetet e pandryshuar po ashtu edhe kërkesa për kompresor të ajrit mbetet e pandryshuar. Ndërsa kërkesa për minigreder hidraulik që montohet në makineri max. 200 kg. largohet në tërësi.

Vlen të citohet neni 7 paragrafi 2 të LPP përmes të cilit përcaktohet se "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik".

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 25.05.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.